

**BNJAKËZIMI**

Kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me kryetarin e Komunës Castenaso të Italisë, Stefano Sermenghi  
 FAQE **4**



**UJËSJELLËS-KANALIZIMET**

Vijimi i projektit në Kamëz, kryebashkiaku Mziu, takim me përfaqësues të KfW  
 FAQE **7**



**INVESTIMET NË PASKUQAN**

Kreu i Bashkisë inspekton punimet në rrugët "Abdyl Frashëri" dhe "Abdyl Elmazi"  
 FAQE **6**



**MZIU NË "SPORT MAGAZIN"**

Kamza vijon e pandalshme rrugëtimin drejt Superligës, fiton edhe me Kastriotin  
 FAQE **8**



Gazetë e Bashkisë Kamëz  
**KAMZA**

E përdyjavshme  
 Nr. 196 mars 2017  
 Çmimi 20 lekë  
 drmediakamez@gmail.com  
 www.kamza.gov.al

**Kryetari i PD, Lulzim Basha, dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu përrurojnë bulevardin "Donald J. Trump" në Kamëz** FAQE 2

**Bashkia Kamëz, anëtarja më e re e Unionit të Bashkive Turke**

Faqe 3

**Punësimi, kryebashkiaku Xhelal Mziu, bashkëbisedim me biznesmenë italianë**

Faqe 4

**Shtohen dy linja të reja në Kamëz, së shpejti fillon shërbimi urban në unazat e qytetit**

Faqe 5

**Në Pallatin e Kulturës Kamëz, koncert i ansamblit "Kaltërsia" me rastin e 7 dhe 8 Marsit**

Faqe 8



**Kreu i Bashkisë Kamëz, vizita dhe takime në disa institucione të Stambollit**

FAQE 3



**NË BRENDËSI**

Drejtorja e Shërbimeve Publike, grupe pune për evidentimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Kamëz

FAQE 5

Tjetër projekt madhor në Paskuqan, ndërtimi i rrugëve "Ejll Deda", "Ismail Qemali" dhe "Isuf Xhelili"

FAQE 6

Afërdita Gjurma, antikomunistja dhe intelektualja e diasporës, nderohet nga kreu i Bashkisë Kamëz

FAQE 3

Ndërtimi i rrugës "Migjeni" në lagjen 5 Kamëz, një tjetër investim i Bashkisë me ndikim të madh social

FAQE 7

FC Kamza e rekordeve nis drejt Superligës

FAQE 8





## Kryetari i PD, Lulzim Basha, dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu përurorjnë bulevardin "Donald J. Trump" në Kamëz

Kryetari i Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha, dhe kryetari i Bashkisë dhe i PD Kamëz, z. Xhelal Mziu, kanë përuruar bulevardin "Donald J. Trump" në lagjen e Frutikuturës. Ky bulevard është një investim i Bashkisë Kamëz, i cili u vjen në ndihmë mijëra qytetarëve. Dhe për të treguar mirënjohjen e tyre për këtë investim të Bashkisë, mijëra qytetarë të Frutikuturës, por edhe të lagjeve të tjera të Kamzës ishin të pranishëm në këtë ceremoni. Kujtojmë se në nëntor të vitit që kaloi, Bashkia Kamëz shpalli "Qytetar Nderi" Presidentin Donald Trump, ndërsa me emrin e tij është emërtuar edhe një prej investimeve më të rëndësishme të kësaj Bashkie.

Në fjalën e mbajtur para bashkëqytetarëve të tij, z. Xhelal Mziu falënderoi përzemërsisht banorët dhe bizneset e Kamzës për partneritetin që kanë pasur dhe për pagesën e taksave dhe tatimeve. Ai u shpreh: "I nderuar z. Lulzim Basha, kryetar i Partisë Demokratike, por njëherazi edhe Kryeministër i ardhshëm i Shqipërisë!

Ndihem shumë i privilegjuar që sot ju jeni këtu, në mesin tonë, në inaugurimin e një rruge shumë të rëndësishme, investim



financiare. Nuk ka ndodhur në këto 25 vite që një popull të distancohet kështu nga qeveria dhe të mos harrojmë që më shumë sesa 45% apo rreth 50% e këtij komuniteti janë të majtë; por edhe të djathtët, edhe të majtët janë persekutuar nga kjo qeveri".

dhe të reja në këtë ditë të bukur pranverore këtu në Kamëz, qytetin e 6-të të Shqipërisë, që është mbi të gjitha mrekullia e punës, djersës suaj, të kryefamiljarëve, të burrave dhe grave, të rinjve dhe të rejave të Kamzës, për të cilët shpreh respektin, mirënjohjen dhe dashurinë time!

Sot, bashkë me kryetarin e Bashkisë, Xhelal Mziun, jemi këtu për të inauguruar një tjetër vepër infrastrukturore. Për vite me radhë, ky qytet, i 6-ti në Shqipëri, ka njohur një bum investimesh, që e kanë shndërruar atë me të vërtetë në një qytet të parametrave gjithmonë e më të pranueshëm, me rrugë të reja, me bulevarde, me shkolla, me qendra kulturore, me ujësjellës dhe kanalizime dhe kështu duhet të jetë sa herë që qytetarët vendosin të themelojnë një qytet të ri, siç ju keni themeluar prej fillimit këtë qytet të ri, që sot është i gjashti në vend, shteti, qeveria dhe pushteti vendor duhet t'i përgjigjen.

Por ky investim sot mban vetëm vulën tuaj dhe të pushtetit vendor, sepse prej ardhjes në pushtet 4 vite më parë, Edi Rama i shpalli luftë Kamzës dhe qytetarëve të saj. I shpalli luftë politike, i shpalli luftë raciale, u shpalli luftë stigmatizuese banorëve që simbolizojnë më shumë se kushdo tjetër lirinë, sepse ishte



"Unë ndihem krenar sot që ju jeni këtu, ndihem krenar që sot ky bulevard ka emrin e Donald Trump-it dhe besoj që fryma ka filluar nga Kamza. Ashtu siç filloi fryma me fitoren e Donald Trump-it në Amerikë, e njëjta situatë ka filluar nga Kamza, ka filluar te Çadra, te Kushtetuta e Re dhe te Republika e Re dhe jam i sigurt që qytetarët e Kamzës mezi presin që ju në zgjedhjet e tanishme që do të realizohen të konfirmohet fitorja dhe fitorja do të fillojë nga Kamza dhe do të mbarojë në gjithë Shqipërinë.



Më lejoni edhe një herë të falënderoj për këtë vrull të madh që u ka dhënë jo vetëm demokratëve, por mbarë popullit shqiptar Kryeministri i ardhshëm, Lulzim Basha!", - tha në fjalën e tij kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Në fjalën e tij drejtuar qytetarëve të Kamzës, kryetari i Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha, u shpreh: "Mirdita dhe mirë se ju gjej vëllezër dhe motra, zonja dhe zotërinj, të rinj

liria që ju mundësoi juve të ndërtonit nga fillimi një jetë të re këtu në Kamëz. Është liria ajo që ju motivon në çdo hap tuajin, në çdo investim tuajin personal, familjar, politik apo bashkiak. E pra, liria është armiku i tiranisë, që përmbysëm para 27 vitesh; është edhe armiku i tiranisë së krimit, armiku i tiranisë së drogës dhe armiku i tiranisë së varfërisë, që Edi Rama dhe një grusht pushtetarësh

**Kryebashkiaku Mziu: I angazhuar maksimalisht për të përdorur më së miri taksat e qytetarëve. I falënderoj përzemërsisht banorët dhe biznesin e kësaj zone për partneritetin që kanë pasur!**

të korruptuar dhe të inkriminuar duan t'i imponojnë Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Tirania ka edhe një armik tjetër, tash 200 vjet. Dhe ky armik i tiranisë janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sot shoh të valëviten në ajër flamujt kombëtarë të Shqipërisë dhe mikut tonë, aleatit tonë strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe unë dua t'ju falënderoj për këtë gjest!

Z. Basha, ndër të tjera tha se është më mirë që rrugëve e shkollave t'u vihen emra që përfaqësojnë demokracinë sesa emra të xhelatëve e kriminelëve të komunizmit. "Më mirë emrin e lirisë e demokracisë që përfaqëson Donald Trump sesa emrat e xhelatëve e kriminelëve të komunizmit që mbajnë rrugët e shkollat tona. Se Mziu është njeriu që e do lirinë, demokracinë ndaj e sulmojnë më shumë nga të gjithë. Para disa muajsh me guxim e të korruptuarit, të drogëtarit dhe të inkriminuarit, Edi Rama vendosi të sulmonte Presidentin amerikan. E bëri këtë i nxitur jo nga interesat kombëtare, por ato personale.

Dy ditë më parë, kur mbarë Shqipëria e mori vesh gjestin tuaj për të emëruar këtë rrugë për Presidentin amerikan, u hodhën në sulm konet e tij. Harron se ai vetë dhe paraardhësit e tij kanë emëruar rrugët e sheshet e shqiptarëve me emra kriminelësh, me emra xhelatësh dhe emra kriminelësh të vrarë në pusitë e krimit të zi. Ky njeri që tregohet me gisht nga shqiptarët si njeriu që ngriti karrierën e tij në aleancë me krimin e organizuar, ka guxim të sulmojë vendimin tuaj për t'i dhënë këtij bulevardit emrin e kampionit të lirisë. Kjo tregon se sa e thellë është kriza morale e Edi Ramës. E falënderojmë Presidentin amerikan Donald Trump", - tha z. Basha.

Bulevardi i përuruar nga z. Basha dhe z. Mziu, ka një gjatësi prej 1 km dhe është i pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme mbitokësore dhe nëntokësore, duke qenë kështu një investim me standarde bashkëkohore. Më e rëndësishmja është se ky investim u shërben mijëra familjeve dhe qytetarëve të Kamzës, por edhe të zonave përreth, duke qenë një arterie e rëndësishme lidhëse mes lagjeve të këtij qyteti, por edhe me kryeqytetin, me aeroportin e Rinasit etj. Një rëndësi të madhe merr ky bulevard, pasi me ndërtimin e tij do të ketë zhvillim të vrullshëm biznesi, për rrjedhojë do të ketë më shumë të punësuar dhe rritje të mirëqenies së qytetarëve të zonës.



i Bashkisë, që ka kushtuar më shumë sesa 1 miliard lekë, me gjatësi prej 1 km dhe që ka emrin "Donald Trump"!

Në fakt, Kamza ishte mësuar në tetë vite, por jo vetëm Kamza, edhe Shqipëria, me inaugurime rrugësh, tunelesh, shkollash, kopshtesh, çerdhesh, por ka 4 vite që Shqipëria ka harruar këto lloj investimesh, përveç fasadave. Por Kamza në këto 4 vite, 0 lekë investime ka marrë. Nuk ka marrë asnjë qindarkë për asnjë shkollë, asnjë kopsht, asnjë çerdhe, as ujësjellës, as kanalizim, madje as nuk e ka parë këtë qytet. Sot Kamza ka 200 mijë banorë. Jemi qyteti i 6-të në Shqipëri. Është persekutuar më shumë se asnjëherë tjetër. Një banor i Kamzës nga buxheti i shtetit merr 33.5 herë më pak lekë sesa mesatarja e Shqipërisë, por nëse u referohemi disa bashkive të majta, diferenca shkon edhe me 200 herë.

Unë si kryetar Bashkie, por edhe si kryetar partie, i angazhuar maksimalisht për të përdorur më së miri taksat e qytetarëve, gjej rastin për t'ifalënderuar përzemërsisht banorët dhe biznesin e kësaj zone për partneritetin që kanë pasur dhe për pagesën e taksave dhe tatimeve. Por këto taksa, këto tatime në këto 4 vite kanë qenë i vetmi burim i këtij qyteti dhe vetëm vitin që shkoi dhe këtë vit që ne jemi në vazhdim, janë bërë e po bëhen më shumë sesa 50 segmente rrugore, më shumë sesa 45 segmente të kanaleve të ujërave të zeza dhe të angazhuar maksimalisht për të bërë jo vetëm investime, por për të qenë pranë qytetarëve edhe me shërbime, sepse qytetarët e Kamzës ndihen të persekutuar jo vetëm në investime, por ndihen të persekutuar edhe në mbështetje





# Kryebashkiaku Xhelal Mziu, në Stamboll të Turqisë, në kuadër të një vizite studimore të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte në Stamboll të Turqisë, në kuadër të një vizite studimore të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë.

Kjo vizitë e delegacionit të SHBSH-së, gjatë datave 19-24 mars, u zhvillua në bashkëpunim me Unionin e Bashkive Turke.



Vizita kishte për qëllim shkëmbimin e eksperiencave në shpërndarjen dhe organizimin e shërbimeve publike, në binjakëzimet ndërmjet bashkive në Turqi dhe vende të tjera, në planifikimin urban etj. Në ditën e parë të vizitës delegacioni nga Shoqata e Bashkive, në të cilin bënte pjesë

edhe kryebashkiaku Mziu, u prit në një takim dhe ishte në shoqërinë e kryetarit të Bashkisë Yskydar-Stamboll, zotit Hilmi Türkmen. Kryebashkiakët nga Shqipëria biseduan për mundësi bashkëpunimi me bizneset turke në turizëm, ekonomi, për shfrytëzimin e burimeve natyrore etj.

Kryebashkiaku i Yskydarit bashkë me kolegët nga Shqipëria vizituan edhe një qendër sociale ku shërbehej nga persona me autizëm, ku u pa se si pa kosto, por me ide, mund të angazhohen njerëz me aftësi ndryshe dhe roli i bashkive për të krijuar akses për të gjithë.

Në pjesën e dytë të ditës kryebashkiakët nga Shqipëria ishin të ftuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Zonave të Gjellbra të Bashkisë Stamboll, ku u njohën me punën dhe strategjitë për gjelbërimin e Stambollit me parqe, lulishte, rrugë etj., me synimin që të arrijnë nga 9 metra katror sipërfaqe e gjelbër për banor në mbi 10 metra katror për banor.

**Takim me kryetarin e Bashkisë Bajrampasha dhe vizita në disa institucione të Stambollit**

Gjatë vizitës që bëri në Turqi, kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, zhvilloi disa takime dhe vizita në institucione të rëndësishme në Stamboll. Ai takoi kryetarin e Bashkisë Bajrampasha, me të cilin shkëmbyen ide për bashkëpunim të mëtejshëm.

Së bashku me kryebashkiakët e tjerë



të delegacionit, bisedua që të thellohet ky bashkëpunim dhe të zgjerohen binjakëzimet edhe me bashki të tjera të Turqisë.

Në këtë drejtim është rënë dakord që të ndërmerren hapa konkretë.

Një tjetër takim ka qenë ai me sekretarin e Përgjithshëm të Unionit të Bashkive Turke, me të cilën është partnerë Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Në këtë takim u ra dakord që të vijojë partneriteti ndërbashkiak, trajnimet dhe

shkëmbimi i eksperiencave në nivel teknik. Me këtë rast u shkëmbyen edhe dhurata dhe certifikatat përkatëse.

Më tej, u zhvillua edhe një vizitë pranë Drejtorisë së Ujësjellës të Stambollit ku u prezantua tema "Menaxhimi i ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza".



Pjesë e veprimtarive në Stamboll ishte edhe vizita pranë ISTAÇ (Menaxhimi i Ambientit, Industrisë dhe Tregtisë - Shoqëri anonime). Kryebashkiakët diskutuan dhe ndanë eksperiencat për menaxhimin e mbetjeve si dhe bënë vizita në terren për të parë nga afër organizimin dhe funksionimin e këtij sistemi.

Kujtojmë se vitin e kaluar, kryebashkiaku Xhelal Mziu mori pjesë në Samitin Ndërkombëtar për Integrimin Social, i ftuar nga Unioni i Bashkive Turke, institucion i cili bashkë me Komisionin Evropian patën bashkëfinancuar projektin ISKEP, me temë përfshirjen sociale.

## Bashkia Kamëz, anëtarja më e re e Unionit të Bashkive Turke

Bashkia Kamëz është anëtarja më e re e Unionit të Bashkive Turke (TDBB). Ky anëtarësim i Bashkisë Kamëz u bë gjatë zhvillimit të mbledhjes së Bordit Administrativ të Unionit të Bashkive Turke.

Në këtë takim u pranuan kërkesat e anëtarësimit në TDBB të Bashkisë Kamëz (Shqipëri); të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë; të Bashkisë Aydamun Şekhlar (Liban); Zuunkharaa (Mongoli); Tunkhel (Mongoli) dhe Tutin (Serbi). Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte vetë i pranishëm në Stamboll, në një vizitë studimore së bashku me të tjerë kolegë, me ftesë të Unionit të Bashkive Turke.

Unioni i Bashkive Turke (TDBB) mbledhi më 15 mars 2017 në Stamboll, Bordin Administrativ, takim i organizuar nga Bashkia Ümraniye, me pjesëmarrjen e autoriteteve vendore që vinin nga katër shtete të ndryshme.

Takimi, nën kryesimin e presidentit të TDBB dhe gjithashtu të kryetarit të Bashkisë Metropolitane të Kocaeli-t, z. İbrahim Karaosmanoğlu, u ndoq nga sekretari i Përgjithshëm i TDBB, Fahri Solak, anëtarët e Bordit Administrativ të TDBB, të cilët janë kryetari i Bashkisë Ümraniye z. Hasan Can, kryetari i

Beykoz z. Yücel Çelikkilek, kryetari i Zeytinburnu z. Murat Aydın, kryetari i Bashkisë Nalaikh të Mongolisë, z. Khaan Sharavkhaan, kryetari i Administratës Shtetërore Kirgistan Issik-gol z. Danır İmanaliev, TRNC, kryetari i Güzelyurt z. Mahmut Özçınar, kryetari i Bolu z. Alaaddin Jilmaz, kryetari i Bilecik z. Selim Yagci, kryetari i Bağcılar z. Lokman Çağırıcı, kryetari i Bashkisë së Kartepe z. Hüseyin Üzülmaz, kryetari i Şahinbey z. Mehmet Tahmazoğlu dhe anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të TDBB që janë kryetari i Safranbolu z.

Necdet Aksoy dhe kryetari i Kandira-s z. Ünal Köken.

Përveç çështjeve të ndryshme të rendit të ditës që u përfunduan, një prej pikave të rëndësishme ishte edhe ajo e pranimit të kërkesave për anëtarësim të Bashkisë Kamëz si dhe i anëtarëve të tjerë të rinj.

Pas mbledhjes dhe ceremonisë së shkëmbimit të dhuratave, kryetarët shkuan në Bashkinë Ümraniye, në Ndërtesën e Shërbimeve të Bashkisë, ku u pritën nga kryetari i Bashkisë, z. Hasan Can.

Mbledhja tjetër e Këshillit Administrativ TDBB është vendosur të bëhet në Bashkinë Bolu në korrik 2017.

## Afërdita Gjurma, antikomunistja dhe intelektualja e diasporës, nderohet nga kreu i Bashkisë Kamëz

**Afërdita është vajza e Adem Gjurrës, anëtarit të Kompanisë 4000 dhe kryetar i Misionit të Parë të organizuar prej Komitetit Shqipëria e Lirë dhe Mbreti Zog për rrëzimin e regjimit komunist**

Kryebashkiaku Xhelal Mziu nderon me certifikatën "Mirënjohja e Qytetit" antikomunisten dhe intelektualen e shquar të diasporës Afërdita Gjurma, e rritur me dashurinë për atdheun. Ajo u vlerësua "Për



kontributin e saj, në mbështetje të vlerave të demokracisë, si disidente, intelektuale, në ruajtjen e integritetit kombëtar". Afërdita një shqiptaro-amerikane antikomuniste dhe intelektuale e shquar, me banim në SHBA, është vajza e Adem Gjurrës, atdhetar, nga Reçi i Dibërës, i cili jo vetëm që nuk u pajtua asnjëherë me regjimin komunist, por sakrifikoji jetën e tij për ta rrëzuar atë sistem

që sapo kishte hedhur rrënjë. Adem Gjurma ishte anëtar i Kompanisë 4000, krijuar nga Komiteti Shqipëria e Lirë për çlirimin e vendit nga komunizmi, anëtarët e së cilës stërviteshin nga anglo-amerikanët me më pas desantoheshin në Shqipëri. Njëri prej tyre ishte dhe Adem Gjurma, babai i Afërditës, i cili si anëtar i Kompanisë 4000 u desantua në Martanesh, ku ishte edhe kryetar i Misionit të Parë të organizuar prej Komitetit Shqipëria e Lirë dhe Mbreti Zog për rrëzimin e regjimit komunist të sapoinstaluar në vendin tonë. Më 20 shkurt, Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, nderoi me Dekoraten e Lartë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" pjesëtarët e "Kompanisë 4000" "Në shenjë vlerësimi të lartë për kontributin e vyer dhe të pamohueshëm në përpjekje për rrëzimin e shtetit diktatorial hoxhist në Shqipëri, duke nxjerrë në pah vlera të çmuara atdhetare si dhe duke sakrifikuar jetën e tyre dhe të familjarëve të tyre për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe euroatlantike". Në këtë ceremoni përshëndeti edhe Afërdita Gjurma në emër të familjarëve të anëtarëve të Kompanisë 4000.





## Kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me kryetarin e Komunës Castenaso të Italisë, Stefano Sermenghi, në kuadrin e binjakëzimit

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, priti në një takim kryetarin e Komunës Castenaso (Castenaso) të Italisë, z. Stefano Sermenghi. Ky takim u zhvillua në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet dy njërive vendore dhe binjakëzimit mes tyre. Pasi i uroi mirëseardhjen mikut nga Italia, z. Mziu u shpreh se këtë bashkëpunim e sheh jo thjesht në kuadrin e binjakëzimit, por edhe në kuadrin e përfitimeve të ndërsjella në shumë fusha, veçanërisht në përfitimin e fondeve dhe projekteve të Komisionit Evropian dhe të Bashkimit Evropian.



Kryebashkiaku Xhelal Mziu në këtë bashkëpunim të ri të Bashkisë Kamëz me Komunën Castenaso, Itali, sheh tri gjëra kryesore: shkëmbimi i përvojave, nxitja e bizneseve për shtrirjen e aktivitetit të tyre në Kamëz duke pasur infrastrukturën e nevojshme dhe, së treti, shfrytëzimi i partneritetit për të përfituar nga fondet e BE-së. Në këtë aspekt, z. Mziu bëri të ditur se Kamza ka përfituar nga binjakëzimet me qytete si Macerata dhe disa qytete të tjera evropiane, si në financim projektsh, ashtu edhe bashkëpunime në fusha të ndryshme me interes të përbashkët. Një prej arritjeve të rëndësishme të Bashkisë ka qenë organizimi në Kamëz i konferencës ndërkombëtare në kuadrin e projektit "JOGGLE", ku morën pjesë bashki nga pesë shtete evropiane. Kryebashkiaku Mziu bëri një përshkrim të qytetit, që nga pozicioni i favorshëm gjeografik, zhvillimi i Kamzës në vitet e fundit etj. Kreu i Bashkisë theksoi progresin e bërë në këto vite, edhe pse është qyteti më i ri në



vend, pa harruar të përmendë se Bashkia Kamëz është bërë një partner i rëndësishëm për biznesin, sidomos atë italian. Gjatë bisedës, z. Mziu u shpreh se ndër avantazhet e qytetit të Kamzës është fuqia punëtore dhe moshja e re e popullsisë, e cila është katër vite më e re se në gjithë Shqipërinë. Duke iu rikthyer partneritetit me biznesin, kryebashkiaku Mziu e njohu homologun italian me politikën fiskale lehtësuese që ka zbatuar dhe zbaton Bashkia e Kamzës.

Pasi falënderoi kryebashkiakun Mziu për mikpritjen e rezervuar, kryetari i Komunës Castenaso, z. Stefano Sermenghi, shprehu bindjen për bashkëpunimin e mëtejshëm mes dy njërive vendore. Ai bëri me dije se Komuna Castenaso është e binjakëzuar me një prej bashkive të Kretës dhe madje mund të organizohet një vizitë e përbashkët në Kretë gjatë muajit tetor,

**“Kryebashkiaku Xhelal Mziu në këtë bashkëpunim të ri të Bashkisë Kamëz me Komunën Castenaso, Itali, sheh tri gjëra kryesore: shkëmbimi i përvojave, nxitja e bizneseve për shtrirjen e aktivitetit të tyre në Kamëz duke pasur infrastrukturën e nevojshme dhe, së treti, shfrytëzimi i partneritetit për të përfituar nga fondet e BE-së.”**

duke shpresuar kështu edhe në një zgjerim të mundshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Bashkia Kamëz, Shqipëri, dhe Komuna Castenaso, Bologna, Itali, ka më shumë se një vit që kanë vendosur lidhje të ngushta mes tyre, në kuadrin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave, për të arritur në nivele bashkëkohore partneriteti, për të ndërmarrë projekte në mbështetje të zhvillimit të Kamzës, në fushën teknike, kulturore, mjedisore, të biznesit etj. Për këtë qëllim janë shkëmbyer korrespondencat dhe programet afatgjata bashkëpunuese nga drejtoratë përkatëse të dy njërive të pushteteve vendore. Ndërkaq, nga palët po ndiqet plotësimi i procedurave zyrtare, një nga të cilat është vendimi i këshillave bashkiakë, që japin miratimin për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit. Lidhja e kësaj marrëveshjeje do të kontribuojë jo vetëm për bashkëpunimin e institucioneve dhe komuniteteve të të dyja qyteteve, por edhe arritjes së standardeve në nivele të pushteteve vendore në proceset e integritimit evropian e më gjërë.

### Punësimi, kryebashkiaku Xhelal Mziu, bashkëbisedim me biznesmenë italianë

#### Mziu: Bashkia Kamëz, partner shumë i rëndësishëm i biznesit

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, pati një bashkëbisedim me përfaqësues të biznesit italian, i cili u organizua nga kompania "BLG Balcan". Kryebashkiaku Mziu fillimisht bëri një prezantim të qytetit të Kamzës, i cili është i pozicionuar vetëm 7 km larg nga qendra e kryeqytetit. Pozicioni gjeografik i Kamzës është më se i favorshëm për të sjellë risitë e duhura në zhvillimin e biznesit vendas dhe të huaj për faktin se ai është i vendosur gjeografikisht në trekëndëshin strategjik: Tirana-aeroporti "Nënë Tereza"-porti detar i Durrësit. Kamza është qyteti më i ri në Shqipëri, por edhe me popullsinë më të re në vend, me 4 vite më të re se mesatarja e vendit, krahu



i lirë i punës është një tjetër faktor shumë i rëndësishëm në këtë qytet ku mbizotëron moshja e re. Ndër të tjera, z. Mziu theksoi se biznesi është promotori i ekonomisë. Në këtë aspekt,

Bashkia Kamëz ka pasur një zhvillim të madh, sidomos për biznesin e vendit apo dhe të huaj, duke qenë se ka një klimë biznesi që bën të mundur jo vetëm zhvillimin e tij, por edhe garantimin e vazhdueshmërisë dhe qëndrueshmërisë. Bashkia Kamëz është një partner shumë i rëndësishëm i biznesit, duke garantuar një barrë fiskale më të lehtë dhe më të mirë në Shqipëri. Mund të thuhet se disa biznese të mëdha kanë shpërngulur bizneset e tyre drejt qytetit tonë kryesisht biznese fashone apo edhe të tjera. Gjithashtu, z. Mziu u shpreh se gjatë vijës kufitare që ndan Paskuqanin me Tiranën, në një gjatësi prej 10 km, është një zonë ku nuk ka biznese, për shkak të mungesës së infrastrukturës, por brenda 2-3 muajsh do të ketë infrastrukturë bashkëkohore. Për pasojë biznesi do të marrë një tjetër zhvillim, duke qenë se është edhe afër Tiranës.


Duke iu referuar Italisë, z. Mziu tha se është një partner i rëndësishëm i ekonomisë në gjithë Evropën, por për Shqipërinë është shumë i rëndësishëm.

Duke iu përgjigjur interesimit të të pranishmëve për zhvillimin e turizmit, kreu i Bashkisë tha se sigurisht që edhe turizmi do të jetë në planifikimin e Bashkisë për të ardhmen, por duke qenë se Kamza është qytet i ri, për momentin nuk është prioriteti kryesor. "Bashkia Kamëz mund të vërë në dispozicion tokë publike që bizneset në bashkëpunim me Bashkinë mund t'i përdorin për të hapur biznese të mëdha. Jam i hapur për të vënë në dispozicion çdo informacion, burime njerëzore për bashkëpunime dhe për kontakte të mëtejshme", - u shpreh z. Mziu gjatë bashkëbisedimit me biznesmenët italianë.

### Trajnim i punonjësve në Bashkinë Kamëz për legjislacionin e ndihmës shtetërore

Në sallën e Këshillit të Bashkisë Kamëz u zhvillua një trajnim për legjislacionin e ndihmës shtetërore me disa nga punonjësit e administratës. Referuesi i trajnimit, z. Sigitas Cemnolonskis, ekspert i IPA-s, i cili vinte nga Lituania, foli për kuptimin dhe parimet kryesore të ndihmës shtetërore. Referuesi lituanes u ndal tek një sërë çështjesh kryesore, siç është legjislacioni për ndihmën shtetërore, përkufizimi i ndihmës shtetërore, kriteret që duhen përbushur, procedurat për njoftimin e ndihmës, skemave të ndihmës apo edhe të ndihmës individuale. Ky ishte trajnimi i parë për punonjësit e administratës së Bashkisë Kamëz në këtë drejtim, ndërsa sa i përket ligjit përkatës, ishte trajnimi i 7-të në vend dhe do të përfshijë të gjitha bashkitë e Shqipërisë. Ky është një ligj monitorues, pra kontrollues, por nuk mund të jetë referues. Sipas z. Cemnolonskis, kur jepet ndihma shtetërore, duhet të përbushen një sërë kushtesh. Këto ndihma nuk duhet të prishin konkurrencën. Gjatë këtij trajnimi u theksua impakti që jep ndihma shtetërore në pushtetin vendor si dhe llojet e ndihmës. Kjo ndihmë i shërben pushtetit vendor sa herë formulon politikën ekonomike të zhvillimit ekonomik të territorit të Bashkisë, të cilat përbëjnë elemente të ndihmës shtetërore. Përpara se të miratohen në Këshillin Bashkiak, ato njoftohen paraprakisht në Komisionin e Ndihmës Shtetërore pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Kjo është hera e parë që ministria bën trajnimin e punonjësve të administratës vendore me këtë temë, e cila ka karakterin e një fushate ndërgjegjësimi për dhënien e ndihmës shtetërore në nivele vendore.






# Shtohen dy linja të reja në Kamëz, së shpejti fillon shërbimi urban në unazat e qytetit

Mars 2017  
GAZETA KAMZA

5



Në territorin e Bashkisë Kamëz shtohen linja të reja të transportit urban në dobi të qytetarëve të saj. Së shpejti do të fillojë shërbimi urban në të gjitha unazat e qytetit të Kamzës.

Linjat qytetëse të reja që u shtohen qytetarëve të Kamzës janë: linja perëndimore e Kamzës që përfshin Valiasin, rrugën “Abdi Bej Toptani”, rrugën “NATO”, rrugën “Liria”, Bulevardi Blu-rruga “Abdi Bej Toptani” si dhe linja lindore e Kamzës që përfshin bulevardin “Berisha”, rrugën “Besëlidhja”, rrugën “Erzeni”, rrugën “Dajti”, rrugën “Banka Botërore”, rrugën “Arbrit”, rrugën “Ramadan Çitarku” dhe kthim.

Këto linja të reja do t’u shërbejnë shumë mijëra qytetarëve të Kamzës, shtresave dhe grupmoshave të ndryshme, të cilat do ta përdorin këtë transport. Në pamundësi për të udhëtuar me mjetet e tyre, tashmë është bërë domosdoshmëri për të gjithë qytetarët që të udhëtojnë me autobusët urbanë në unazat e qytetit ose që e preferojnë dhe e përdorin këtë shërbim rrugor qytetës, si më të leverdishëm nga ana financiare.

Kjo është një tjetër strategji shumë e domosdoshme e Bashkisë Kamëz për të qenë sa më pranë qytetarëve të saj si dhe për t’u ofruar sa më shumë shërbime atyre.

## Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit intensifikon shërbimet në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit ka shtrirë shërbimin në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz për të minimizuar pikat e ndotura me problematikë të mprehtë.

Është punuar në identifikimin e situatës dhe është shërbyer edhe me orare të pakufizuara për të sjellë tek qytetarët dhe qyteti mjedisin e dëshiruar.

Kjo nismë nuk do të jetë e vetmja, por do të jetë një praktikë e shtrirë gjatë gjithë kohës. Strukturat e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit vazhdojnë të jenë të mirorganizuar për të përballuar ngarkesat e shërbimeve sipas sektorëve, por krahas tyre po vazhdon puna në të gjitha shërbimet që ofron kjo ndërmarrje.

Këto shërbime janë një zbatim i detyrave funksionale që ka ndërmarrja, por edhe një orientim që kryebashkiaku Xhelal Mziu ka dhënë në drejtim të kësaj strukture, për të realizuar në kohë shërbimet e gjera që ofron kjo ndërmarrje për qytetarët e Bashkisë Kamëz.



## Gjendja Civile Kamëz, punë intensive dhe korrekte për saktësimin dhe plotësimin e adresave të shtetasve

Drejtorja e Gjendjes Civile në Kamëz po punon intensivisht dhe në mënyrë korrekte për saktësimin dhe plotësimin e adresave të shtetasve në Sistemin Kombëtar të Shtetasve (NCR). Krahas punës së përditshme në shërbim dhe komunikim korrekt me qytetarët, operatorët e kësaj drejtorie po punojnë shumë edhe për përgatitjen e njoftimeve të të gjithë qytetarëve që banojnë në qytetin e Kamzës, por që pasaportizimin nuk e kanë në Kamëz, por diku tjetër. Kjo është bërë e mundur në bashkëpunim edhe me Drejtorinë Juridike. Përveç korrespondencave të ndryshme që kjo drejtori ka me drejtoritë e tjera, komunikimit midis zyrave të gjendjes civile, prefekturës dhe ambasadave, gjithashtu janë përgatitur, printuar, vulosur dhe shpallur për herën e tretë listat e zgjedhësve. Gjatë muajve janar dhe shkurt 2017, punonjësit e gjendjes civile përveç sqarimeve të qytetarëve për çdo paqartësi që kanë është marrë edhe me shpërndarje formularësh pasaportash dhe verifikime, firmosje formularësh si dhe janë marrë edhe me kthim përgjigje për shkresat e hyra dhe të dala. Gjithashtu, po në muajt janar janë emetuar 7500 certifikata në zyrat e Gjendjes Civile në Kamëz dhe 3146 në zyrën e Gjendjes Civile në Njësinë Administrative Paskuqan. Ndërkaq, në muajin shkurt janë emetuar 6500 certifikata në zyrat e gjendjes Civile në Kamëz dhe 3156 në Njësinë Administrative Paskuqan etj.

## Varianti final i planit të biznesit, takim mes përfaqësuesve të KfW dhe Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve

Në sallën e Këshillit Bashkiak u zhvillua takimi në lidhje me prezantimin e planit të biznesit për Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve për periudhën 2017-2021. Ky ishte varianti final i këtij plani, i punuar nga grupet e ekspertëve të KfW në bashkëpunim me stafin e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz. Në këtë prezantim u bë i qartë qëllimi dhe përdorimi i planit të biznesit si dhe procesi i planifikimit të tij. Plani në vetvete përmban organizimin e menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe statusin e ri që do të marrë Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve. Në bazë të riorganizimit të kësaj ndërmarrjeje do t’u kushtohet vëmendje çështjeve të shërbimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të parashikuara në planin e biznesit. Plani përmban strategjinë e funksionimit të rrjeteve të furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës së Kamzës si dhe strategjinë e rregullimit të tarifave. Këto sigurisht që janë në funksion dhe vijnë falë paraqitjes së mirë të performancës që ka pasur Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve deri më tani. Kjo premtim rritjen dhe zgjerimin e furnizimit me ujë të pijshëm si dhe përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit për sa u përket kanalizimeve të ujërave të ndotura. Komuniteti i Bashkisë Kamëz do të jetë përfitues i drejtpërdrejtë i projektit madhor, falë të cilit do të furnizohen

me ujë të pijshëm 24 orë në ditë dhe me një cilësi të lartë shërbimi.

## Mbledhja e Këshillit Bashkiak, vijon mbështetja e Bashkisë Kamëz për familjet në nevojë

Ashtu si edhe muajt e tjerë, është zhvilluar mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak të Kamzës. Një pjesë të mirë të projektvendimeve të miratuara e zinin ato për mbështetjen e familjeve dhe shtesave të ndryshme në nevojë. Edhe pse nga ana e qeverisë është centralizuar çdo procedurë për dhënien e ndihmës ekonomike, si për familjet ashtu edhe për personat me aftësi të kufizuara, Bashkia Kamëz ka ndërmarrë vetë nisma për të qenë pranë atyre qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje. Në rendin e ditës bënin pjesë projektvendimet për dhënien e ndihmës ekonomike për përudhën 1- 31.3.2017 në Kamëz dhe Paskuqan; për personat me aftësi të kufizuara; për rastet e veçanta në muajin mars; dhënia e kompensimit të energjisë elektrike për muajin shkurt 2017; miratimi i dhënies së ndihmës financiare për familjen e z. Kol Mirash Ulndreaj, shtëpia e të cilit është dëmtuar nga zjarri, dhe dërgimi për financim për pamundësi dhe mungesë fondesh pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile. Ndërkaq, pjesë e mbledhjes së Këshillit kanë qenë edhe projektvendime të tjera, të cilat u miratuan nga këshilltarët e pranishëm.

## Drejtorja e Shërbimeve Publike, grupe pune për evidentimin e komuniteteve romë dhe egjiptiane në Bashkinë Kamëz

Drejtorja e Shërbimeve Publike, në Bashkinë Kamëz ka ngritur grupe pune për evidentimin dhe regjistrimin në terren të komunitetit rom dhe egjiptian. Duke qenë se janë komunitetet më në nevojë, ato paraqesin problematika të thella sociale që nga regjistrimi i tyre në gjendjen civile, kushtet e vështira të banesave, të cilat janë jashtë standardeve për të jetuar. Evidentimi i tyre po bëhet me synimin e përfshirjes së këtyre grupeve në politikat e strehimit social. Ky proces, i cili do të zhvillohet në terren, do t’i shërbejë Bashkisë Kamëz për një statistikë të saktë dhe për njohjen sa më të mirë të këtyre komuniteteve, duke u ofruar atyre pastaj edhe një mbështetje më të madhe. Evidentimi i komuniteteve të mësipërme do të bëhet në bashkëpunim me ndërlihdësit me komunitetin, me Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike, si dhe me shoqatat që përfaqësojnë komunitetet që operojnë në Bashkinë Kamëz. Nga ana e Bashkisë Kamëz dhe e kryebashkiakut Xhelal Mziu shtresat e mësipërme kanë qenë në fokusin e tyre për t’i ndihmuar dhe mbështetur brenda mundësive të pushtetit vendor. Përveç procesit të mësipërm që do të realizojë Drejtorja e Shërbimeve Publike, prioritet i punës së kësaj drejtorie është prania në rastet e fatkeqësive të ndryshme, si rastet e djegieve të banesave dhe të përmbytjeve në zonë. Në një kohë të shpejtë u është dhënë ndihma të dëmtuarve. Kjo ndihmë ka përfshirë familje të ndryshme në nevojë, si në Kamëz ashtu edhe në Paskuqan.





## Kreu i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu, inspekton punimet në rrugët “Abdyl Frashëri” dhe “Abdyl Elmazi” në Paskuqan

Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspektoi punimet në rrugët “Abdyl Frashëri” dhe “Abdyl Elmazi” në Paskuqan 2, Vresht. Në këtë zonë po kryhen disa investime. Një prej tyre është zgjerimi dhe ndërtimi i segmenteve rrugore në rrugët “Abdyl Frashëri” dhe “Abdyl Elmazi”.



E gjithë gjatësia e investimit prej rreth 350 ml, do të ketë parametrat e duhur të një rruge bashkëkohore, duke përfshirë shtresat e asfaltit, kanalizimet, bankinat etj. Gjerësia e asfaltit do të jetë 5 ml, ndërsa gjerësia tërësore bashkë me bankinat do të jetë 6 ml.

Ky nuk është investimi i vetëm në këtë zonë, pasi aty po realizohet edhe ndërtimi i një tjetër rruge, me të gjithë parametrat. Përveç këtij investimi, rreth 30 projekte të reja për vitin 2017 do të realizohen në Njësinë Administrative të Paskuqanit, për të bërë të mundur përmirësimin e dukshëm të infrastrukturës urbane në këtë zonë.

Ky është një tjetër premtim i mbajtur i z. Mziu, i cili ka garantuar se investimet e Bashkisë nuk do të mbarojnë me kaq, por do të vijin duke u shtuar, pavarësisht nga indiferenca e një qeverie të rënë tashmë, e cila nuk ka akorduar asnjë financim për qytetarët dhe Bashkinë e Kamzës.

### Një rrugë e re do të ndërtohet në Paskuqan 2, Vresht

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ka inspektuar punimet që po kryhen në një tjetër investim në lagjen Paskuqan 2, Vresht. Në këtë zonë po ndërtohet një rrugë e re që përfshin disa segmente rrugore, siç është rruga “Gramozi”, rruga “Ejup Topojani”, si dhe dy segmente tërësisht të reja që janë hapur nga Bashkia Kamëz. Bashkë me rrugën e re do të ndërtohet edhe rrjeti i kanalizimeve.



Gjatë inspektimit, kryebashkiaku i Kamzës është takuar edhe me banorë të zonës, të cilët i kanë shprehur atij përgëzimet dhe falënderimet për këtë premtim të mbajtur. Pasi kanë falënderuar kryebashkiakun Mziu për këtë investim, banorët e zonës kanë theksuar se kjo është një punë konkrete, e realizuar nga Xhelal Mziu, dhe jo një nga premtimet dhe fjalët boshe të Edi Ramës.

Investimet publike në infrastrukturën rrugore që po realizohen aktualisht në Paskuqan, kanë një ndikim të jashtëzakonshëm social për banorët e kësaj zone. I tillë është edhe projekti për ndërtimin e segmentit të mësipërm rrugor në Paskuqan 2, Vresht, si dhe rrjeti i kanalizimeve.

Ky projekt bënte pjesë në investimet e buxhetit të Bashkisë për vitin 2016, duke u financuar kështu vetëm me të ardhurat e Bashkisë Kamëz. Realizimi i këtij investimi sjell ndikim pozitiv të jashtëzakonshëm social, për shkak se përmirëson kushtet e jetesës për banorët e zonës.

Përveç lehtësisë së kalimit për automjetet dhe këmbësorët, edhe kanalizimet nuk do të jetë më një problematikë për banorët.

### Ndërtimi i rrugës “Ymer Haxhi Prizreni” në Babrru-Shpat, investim i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz për vitin 2017

Rreth 1 km do të jetë gjatësia e rrugës “Ymer Haxhi Prizreni” ku do të investohet këtë vit nga Bashkia Kamëz. Kjo rrugë ndodhet në lagjen Babrru-Shpat të Njësisë Administrative të Paskuqanit. Për realizimin e këtij investimi Bashkia Kamëz pati ndërmarrë edhe një aksion për lirin e hapësirave publike përgjatë saj. Në 1050 ml të gjatësisë së kësaj rruge, parametrat do të jenë bashkëkohorë, me qëllimin për të ofruar një infrastrukturë të një standardi të lartë për banorët e kësaj zone. Duhet thënë se zbatimi i projektit për ndërtimin e rrugës “Ymer Haxhi Prizreni” sjell një ndikim të madh social te qytetarët, pasi përmirëson ndjeshëm kushtet në të cilat ndodhej kjo rrugë, duke sjellë kështu lehtësinë e lëvizjes, si të këmbësorëve ashtu edhe të automjeteve.



Ndërtimi i rrugës “Ymer Haxhi Prizreni” në Babrru-Shpat është një prej 50 projekteve të hartuara të Bashkisë Kamëz për vitin 2017, shumica e të cilave do të realizohen në Paskuqan.

### Bashkia Kamëz, tjetër projekt madhor në Paskuqan, ndërtimi i rrugëve “Ejll Deda”, “Ismail Qemali” dhe “Isuf Xhelili”

Bashkia Kamëz do të realizojë një tjetër projekt madhor në Paskuqan, i cili përfshin ndërtimin e 3 rrugëve: “Ejll Deda”, “Ismail Qemali” dhe “Isuf Xhelili”. Këto rrugë ndodhen në lagjen Paskuqan 2. I gjithë investimi ka një gjatësi më shumë se 1 km (1225 ml) dhe gjerësi 5 ml.

Ndërtimi i këtyre rrugëve përbën një prej momenteve më të rëndësishme të krijimit të një infrastrukture bashkëkohore në zonën e Paskuqanit, gjë e cila ka munguar deri tani.

Ky është edhe angazhimi kryesor i kryebashkiakut Xhelal Mziu, gjithashtu dhe një premtim i realizuar tashmë. Edhe pse me shumë vështirësi, për shkak të mosfinancimit të asnjë projekti nga qeveria, Bashkia po bën realitet synimet e saj për një ndërhyrje themelore në infrastrukturën urbane të Paskuqanit. Kujtojmë se që në vitin 2016, si viti i parë pas reformës administrative-territoriale, Bashkia Kamëz ka planifikuar pjesën më të madhe të investimeve në Paskuqan. Ndërsa këtë vit, investimet e parashikuara për këtë zonë janë më të shumta.



Mes tyre është edhe ndërtimi i 3 rrugëve të mësipërme, të cilat përbënin një shqetësim për banorët. Bazuar në kërkesat

e tyre, specialistët e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve kanë hartuar projektin për ndërtimin e rrugëve “Ejll Deda”, “Ismail Qemali” dhe “Isuf Xhelili”, realizimi i të cilit do të krijojë lehtësi në lëvizjen e qytetarëve dhe automjeteve, duke ndikuar edhe në zhvillimin e aktiviteteve private përgjatë këtyre segmenteve rrugore.

### Ndërtimi i KUN dhe i rrugës “Zgjimi” (vazhdim) + rruga “Vodafone” në Valias, tjetër projekt i Bashkisë Kamëz për vitin 2017

660 ml do të jetë gjatësia e segmentit ku do të investohet nga ana e Bashkisë Kamëz këtë vit në Valias. Bëhet fjalë për vazhdimin e rrugës “Zgjimi” dhe rrugën “Vodafone”. Në gjerësinë e rrugës prej 5 ml, do të ndërtohet edhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura.

Ky investim kompleks i Bashkisë vjen në një kohë kur nga ana e qeverisë nuk është dhënë asnjë qindarkë për ndërtimin e infrastrukturës në qytetin e Kamzës. Megjithatë, Bashkia Kamëz dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu, duke u qëndruar me vendosmëri premtimeve dhe synimeve për përmirësimin e infrastrukturës urbane në qytet, ka shfrytëzuar çdo burim për të realizuar investime me ndikim të madh social.



Një prej tyre është edhe projekti i mësipërm, që u jep zgjidhje disa shqetësimeve, duke filluar që nga ndërtimi i rrugës, nga ndërtimi i kanalizimeve, krijimi i lehtësive për lëvizjen e këmbësorëve dhe automjeteve, si dhe ndikimi për zhvillimin e bizneseve dhe rritjen e numrit të të punësuarve.

### Në Paskuqan 2 së shpejti nis investimi në rrugët “Avni Rustemi” dhe “Gjok Doçi”

Në investimet e vitit 2017, të cilat ka parashikuar t'i realizojë Bashkia Kamëz, bëjnë pjesë edhe dy rrugë në lagjen Paskuqan 2. Bëhet fjalë për rrugët “Avni Rustemi” dhe “Gjok Doçi”.



Gjatësia totale e investimit do të jetë 570 ml dhe gjerësi 5 ml.

Këto dy segmente rrugore ndodhen në një zonë, e cila ka një dendësi të madhe për sa i përket popullimit të saj. Kështu që, ndërtimi i tyre do të japë impakt të madh social te këta qytetarë. Duke parë kërkesat dhe nevojat e banorëve të zonës, rëndësinë që kanë këto rrugë për kushtet e tyre të jetesës, specialistët e Urbanistikës në Bashkinë Kamëz kanë bërë të mundur hartimin e një projekti bashkëkohor.

Në vëmendjen e Bashkisë do të jenë edhe shumë investime të tjera, si në zonën e Paskuqanit ashtu edhe në Kamëz. Duhet thënë se me 50 projekte të reja vetëm për vitin 2017, Kamza është një kantier ndërtimi, pjesë e rëndësishme e të cilit është Njësia Administrative e Paskuqanit.





## Vijimi i projektit të ujësjellës-kanalizimeve në Kamëz, kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me përfaqësues të KfW

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, priti në një takim pune përfaqësuesin e KfW-së, z. Uwe Moshage, për ecurinë e fazave të tjera të projektit të ujësjellës-kanalizimeve në qytetin e Kamzës. Duke e falënderuar për mikpritjen, z. Moshage u shpreh se në përgjithësi projekti ka shkuar mirë. Përfundimi i fazës së parë ka respektuar afatet e parashikuara.

Nga ana e tij, kryebashkiaku Mziu e falënderoi përfaqësuesin e KfW-së për punën, angazhimin e treguar gjatë gjithë këtyre viteve për projektin e ujësjellës-kanalizimeve në qytetin e Kamzës. "Kam qenë shumë ilumtur që jeni pjesë e këtij projekti, që në këtë mes është KfW, si lider në këtë fushë në gjithë botën", - u shpreh ndër të tjera z. Mziu, i cili më tej



vijoi: "Gjatë zbatimit të fazës së parë të projektit kemi pasur probleme me banorët, për shkak të punimeve që kryheshin dhe ndikimit në infrastrukturën rrugore. Por tani, me realizimin e projektit, ata janë ndërgjegjësuar dhe e shohin ecurinë e projektit dhe të mirat e tij. Edhe pse disa rrugë janë dëmtuar gjatë procesit të fazës së parë të projektit, shpresoj që në fund të projektit gjithçka do të jetë aty ku duhet. Shpresojmë që fazat e tjera të përfundojnë dhe të prekin edhe pjesën tjetër të qytetarëve dhe mbetëm me shpresë që do të shkurtrohet koha mes fazës së parë dhe asaj të dytë. Vonesat e fillimit të fazës së dytë kanë krijuar kosto, siç janë kanalizimet e ujërave të ndotura, një pjesë të cilave i kemi bërë me fondet e vetë Bashkisë, duke lënë pa financuar investime të tjera. 40% e investimeve të Bashkisë kanë shkuar për ndërtimin e kanalizimeve".

Gjatë takimit, z. Mziu theksoi se sfidë ngelet fillimi sa më parë i fazës së dytë. "Sfidë ngelet fillimi i fazës së dytë, për të mënjtuar edhe konflikte sociale ndërmjet banorëve. Gjithashtu, kërkojmë që disa segmente kanalizimesh të futen



në fazën e dytë, në mënyrë që fondet e Bashkisë të shkojnë për investime të tjera publike. Edhe për fazën e dytë mbetemi të angazhuar për të bërë maksimumin, që me mbarimin e saj, të vihet dorë në pikat më të nxehta; të ketë furnizim me ujë në të gjithë territorin; të jetë i ndërtuar rrjeti i plotë i kanalizimeve", - tha kreu i Bashkisë.

Ndërkaq, përfaqësuesi i KfW-së, z. Uwe Moshage, u shpreh: "Ju falënderoj ju si kryetar Bashkie, Bashkinë si dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve për bashkëpunimin e shkëlqyer të deritanishëm. Faza e parë ishte parashikuar për 18 muaj dhe mbaroi pothuaj në kohë. Mbaroi në kohë për shkak të bashkëpunimit të të gjitha palëve. Jemi të përfshirë në shumë projekte, por rasti i Kamzës është nga më të rrallët që ka përfunduar me sukses dhe në kohë. Është e vërtetë që ka pasur një impakt jo të kënaqshëm në fillim të banorët, por në atë zonë ku ka hyrë faza e parë, banorët e vlerësojnë punën e bërë. Objekti i fazës së dytë është për të plotësuar gjithë territorin me furnizim me ujë dhe fillimi i KUN-ve. Për këtë ne kemi marrë në konsideratë kolektorët ekzistues për t'i integruar në projektin e fazës së dytë. Gjithashtu, faza e tretë dhe i gjithë projekti mbaron me ndërtimin e një impianti të përpunimit të ujërave të ndotura. Kjo, në mënyrë që këto ujëra të mos shkarkohen në lumenj apo hapësira të tjera, por të përpunohen në impiant".

Sipas kryebashkiakut Mziu: "E rëndësishme është furnizimi me ujë të shtrihet në gjithë territorin. Duhet garantuar furnizimi me ujë i rrjetit, gjë që është e pamundur në kushtet kur disa zona menaxhohen nga Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë. Duhet një linjë e dytë nga Bovilla, e veçantë për Kamzën, për të furnizuar depon e ndërtuar në fazën e parë të projektit. Kjo do të kishte edhe më pak kosto, por do të

**Përfaqësuesi i KfW: Ju falënderoj ju si kryetar Bashkie, Bashkinë si dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve për bashkëpunimin e shkëlqyer të deritanishëm. Faza e parë ishte parashikuar për 18 muaj dhe mbaroi pothuaj në kohë. Mbaroi në kohë për shkak të bashkëpunimit të të gjitha palëve. Jemi të përfshirë në shumë projekte, por rasti i Kamzës është nga më të rrallët që ka përfunduar me sukses dhe në kohë.**

zgjidhte përfundimisht furnizimin me ujë të qytetarëve të Kamzës, madje do të përfitonin edhe zonat përreth. Pra, kërkojmë që Ujësjellësi i Kamzës të jetë i pavarur nga UKT".

Ndërkaq, z. Moshage kërkoi që të ndërtoheshin zyra të reja për Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve. Z. Mziu theksoi se është dakord që të ndërtohet një ndërtesë e re, zyra të reja, që të ketë gjithë infrastrukturën e nevojshme bashkëkohore. Për këtë kryebashkiaku Mziu garantoj edhe sipërfaqen e tokës ku mund të ngrihen ndërtesa e re. Në të njëjtën kohë, z. Mziu u shpreh se ishte dakord që të mos ketë shkarkim të ujërave të papërpunuara në lumenj, por përpara ndërtimit të impiantit duhet që të ndërtohet i gjithë rrjeti i kanalizimeve në gjithë territorin. Edhe për impiantin kreu i Bashkisë theksoi se është gjetur trualli, i cili është pranë vendit ku do të ndërtohet edhe impianti i përpunimit të mbetjeve urbane. Një problem tjetër që ngriti kryebashkiaku Mziu ishte se Ujësjellësi i Kamzës nuk është bërë ende sh.a., për shkak të pengesave që sjellë Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë. Gjithashtu, z. Mziu e informoi përfaqësuesin e KfW-së se përveç këtyre pengesave dhe bllokimeve, edhe qeveria qendrore nuk ka akorduar asnjë financim për investime në Bashkinë Kamëz, duke diskriminuar një qytet të tërë.

Z. Moshage u shpreh se nga ana e KfW-së do të bëhet më e mira për vijimin e fazave të tjera të projektit.

### Vijojnë punimet në rrugën "Demokracia" në Paskuqan, inspekton punimet kryetari i Bashkisë, Xhelal Mziu

Rruga "Demokracia" në Paskuqan, një prej investimeve madhore të Bashkisë Kamëz, është drejt përfundimit. Për të parë ecurinë e punimeve ka qenë i pranishëm në terren herë pas here kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu. Të gjitha segmentet e investimit kanë një gjatësi rreth 7 km i gjatë. Projekti për rehabilitimin e plotë të rrugës "Demokracia", që është edhe rruga kryesore e Paskuqanit, është drejt realizimit të tij. Në projektin e hartuar nga specialistët e urbanistikës në Bashkinë Kamëz është parashikuar ndriçimi rrugor dhe gjelbërimi gjatë gjithë gjatësisë. Ndërkaq, ky segment rrugor i rëndësishëm për komunitetin e banorëve do të ketë trotuare në të dyja anët, të cilat



do të bëhen me pllaka. Gjithashtu, kjo rrugë do të jetë e pajisur edhe me sinjalistikë horizontale dhe vertikale. Ky projekt është ndër më të rëndësishmit që ka hartuar Bashkia Kamëz për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonën e Paskuqanit. Kjo, për vetë faktin se ky segment rrugor bën lidhjen jo vetëm të mijëra banorëve të kësaj zone me Tiranën dhe Kamzën, por edhe të gjitha njësitë administrative përreth.

### Ndërtimi i rrugës "Migjeni" në lagjen 5 Kamëz, një tjetër investim i Bashkisë me ndikim të madh social

Banorëve të lagjes nr. 5 Kamëz do t'u shtohet edhe një investim në vitin 2017, që do të ketë ndikim të madh social. Është pikërisht rruga "Migjeni" që do të asfaltohet tërësisht, duke i ardhur në ndihmë një pjesë të madhe të komunitetit të zonës. Rruga "Migjeni" përbën një nyjë të rëndësishme, sepse ajo bën lidhjen



e bulevardit "Berisha" me rrugën "Besëlidhja" që kalon në Bathore. Me këtë investim të Bashkisë Kamëz merr zgjidhje edhe problemi i kalimit nëpër këtë rrugë, sidomos gjatë reshjeve, kur ka vështirësi qarkullim në të. Përveç banorëve të zonave që lidh kjo rrugë, ajo u shërben nxënësve që të shkojnë në shkollat e lagjeve përkatëse. Gjatësia e segmentit rrugor që do të ndërtohet është 286 ml dhe gjerësia 4.5 ml.

### Në Fushë-Kërçik, së shpejti ndërtohet rruga "Nënë Tereza", investim i Bashkisë Kamëz

Në një nga lagjet e Paskuqanit, në Fushë-Kërçik, do të nisë ndërtimi i rrugës "Nënë Tereza". Ajo do të shërbejë si një arterie lidhëse e rëndësishme për banorët e zonës me rrugën kryesore "Demokracia". Kjo rrugë aktualisht është funksionale, por ndërtimi i saj, me të gjithë parametrat e duhur, ka një rëndësi të madhe sociale dhe ekonomike, pasi ndikon në qarkullimin e lirë automjeteve dhe të njerëzve, si dhe në lehtësimin e lëvizjes së komunitetit. Kjo rrugë do të ketë një gjatësi prej 302 ml, me gjerësi 4.5 ml. Në zgjidhjen



planimetrike është pasur parasysh që asfaltimi i rrugës të bëhet në gjithë aksin e rrugës ekzistuese dhe të lihen hapësirat e nevojshme për zhvillimin e infrastrukturës nëntokësore, duke sistemuar rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura.





# Kryebashkiaku Xhelal Mziu, i ftuar në emisionin “Sport magazin” në “Ora News”

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, i ftuar në emisionin “Sport magazin” të gazetarit Altin Sulçe në “Ora News”, ka diskutuar rreth ecures së ekipit të futbollit Kamza. Skuadra e Kamzës kryeson e vetëm Kategorinë e Parë me 46 pikë dhe është në rrugën e duhur drejt Superligës. Mziu ka pohuar për ecurinë shumë pozitive të skuadrës dhe që synimi i përbashkët me presidentin dhe trajnerin ka qenë krijimi i një ekipi me projekte afatgjata. Ndërtimi i ekipit që është në vendin e parë të klasifikimit ka filluar që në fazën e dytë të kampionatit të kaluar. Siç e pohon edhe vetë Mziu për “Sport magazin” ka vite që bashkëpunojnë, ndërsa në këtë vit kanë pasur një angazhim edhe më të madh, ku në organikën e Kamzës ka lojtarë shumë cilësorë, të cilët kanë treguar gjatë gjithë kampionatit. Performanca e skuadrës është shumë pozitive, pasi deri më tani ka koleksionuar vetëm një humbje e një barazim si dhe është skuadra më “Fair play”. Kryesorja gjatë këtij kampionati është se skuadra luan vërtet një futboll të admirueshëm dhe janë të parët me një diferencë të theksuar me vendin e dytë dhe të tretë. Kamza ka një angazhim për t’i ftuar të gjitha ndeshjet dhe për t’u shpallur kampione e Kategorisë së Parë dhe më pas për t’u ngjitur në Superligë.

Ashtu siç e pohon edhe Mziu, është shumë korrekt me pagesat, pasi vonesat tek ekipi i Kamzës nuk ndodh qoftë edhe



një ditë të vetme. Përveç ecures së deritanishme të skuadrës, kryebashkiaku Xhelal Mziu ka folur edhe për projektin e stadiumit. “Sa i përket infrastrukturës ne kemi një stadium i cili është ndër më të mirët në Shqipëri, ka rreth 5 mijë vende, ka pasur një fushë shumë të mirë, por tani është amortizuar. Me mbarimin e këtij kampionati ne do të rikonstruojmë tapetin e fushës, pse jo, edhe ndriçimin e saj. Kemi bërë një bashkëbisedim për një bashkëpunim me presidentin e Federatës së Futbollit dhe do të jenë bashkëfinancues Bashkia



dhe Federata për të pasur një stadium që të jetë bashkëkohor, që të shërbejë jo vetëm për Kamzën që do të jemi në Superligë, por edhe për skuadrat e tjera”, - u shpreh z. Mziu. Ekipi i Kamzës është ideuar mirë që në fillim të sezonit dhe po tregon stabilitet në lojën e tij. Ka një koordinim të shkëlqyer midis përvojës dhe talenteve të reja. Emra si Sefa dhe Morina dhe djem të rinj me perspektivë japin një produkt të ri interesant. Nën mbikëqyrjen e kryebashkiakut Mziu dhe në kujdesin e presidentit Qarri, Kamza është gati të vijë në futbollin e madh.

## Kamza fiton 1-0 ndaj Erzenit, vendos Mehmeti me një gol të bukur që në pjesën e parë

Skuadra e Kamzës po zhvillon një kampionat të madh këtë sezon në Kategorinë e Parë. Që prej javës së parë vijon të qëndrojë e vetme në vendin e parë në tabelën e klasifikimit. Rezultatet shumë pozitive të njëpasnjëshme në çdo ndeshje që ka arritur gjatë fazës së parë dhe të dytë, po vijojnë me këtë ritëm edhe në fazën e tretë. Fazën e tretë e ka nisur me një fitore të rëndësishme për rrugën drejt objektivit madhor, Superligës. Me këtë fitore, skuadra e Kamzës është me një këmbë në Superligë dhe ka treguar që është skuadra më e mirë e Kategorisë së Parë. Merita madhore për rezultatet shumë pozitive në dy fazat e para i shkojnë kryebashkiakut të Kamzës, z. Xhelal Mziu, që së bashku me presidentin e ekipit, z. Naim Qarri, kanë ndërtuar një ekip shumë cilësor, me lojtarë edhe të Superligës. Bashkëpunimi i tyre për të nxjerrë Kamzën menjëherë në Superligë po merr formë, pasi Kamza është në rrugën e duhur drejt realizimit të objektivave të vendosur në fillim të kampionatit. Skuadra e Kamzës ka zhvilluar ndeshje shumë të bukura si brenda ashtu edhe jashtë fushe. Futbollistët kanë treguar karakter, shpirt gare dhe harmoni mes tyre. Qytetarët e Kamzës e meritojnë që ekipi i qytetit të tyre të luajë sezonin e tjetër në mesin e skuadrave më të mira të Superligës.



## FC Kamza e rekordeve niset drejt Superligës

*Projekti i kryebashkiakut Mziu me presidentin Qarri për ngjitjen e Kamzës në Superligë po merr formë çdo ditë e më shumë*

Ekipi i Kamzës këtë sezon futbollistik 2016-2017 është ekipi i rekordeve i Kategorisë së Parë. Në grupin A të kësaj kategorie është skuadra e vetme në këtë kategori, e cila ka marrë 19 fitore, 3 barazime dhe vetëm 1 humbje. Puna e shkëlqyer e bërë nga drejtuesit e Kamzës me në krye kryebashkiakun Xhelal Mziu kanë formuar një ekip pretendent, me synim fitimin e titullit kampion të Kategorisë së Parë dhe ngjitjen e menjëhershme në mesin e skuadrave më të mira të Superligës. Që në fazën përgatitore janë afruar lojtarë shumë cilësorë, madje në përbërjen e skuadrës ka shumë lojtarë të cilët kanë luajtur në nivele shumë të larta të futbollit shqiptar.

Me futbollistë të talentuar dhe me një stol shumë cilësor, skuadra e Kamzës nuk e diskuton ngjitjen në Superligë, pasi edhe objektivat e fillimsezonit po realizohen. Konkurrenca është shumë e madhe në skuadër, pasi edhe lojtarët të cilët nuk kanë qenë pjesë stabilë e formacionit bazë, sa herë që janë aktivizuar, kanë dhënë kontributin e tyre në çdo ndeshje. Përveç 11-shes titullare, edhe lojtarët e stolit janë pothuajse të njëjtit nivel. Skuadra e Kamzës i është mirënjohëse ish-trajnerit Bledar Devolli për punën e palodhshme që ka bërë gjatë këtyre ndeshjeve në drejtimin e skuadrës. Ish-trajneri është larguar vetë nga drejtimi i skuadrës, për arsyt e veta personale.

Pavarësisht nga ndryshimi i trajnerit, morali në skuadër është shumë i lartë. Trajneri i ri Ramadan Ndreu ka marrë përgjegjësitë e tij në vazhdimin e objektivit madhor të vënë në fillim të kampionatit, ngjitjen e Kamzës në Superligë këtë sezon. Edhe trajneri Ramadan Ndreu është shprehur me superlativa për skuadrën, pasi renditet në vendin e parë dhe ka lavdëruar punën e mirë nga paraardhësi i tij, që ka bërë me formimin e grupit të ekipit, që në këtë moment renditet i pari. Me të marrë detyrën e të trajnerit, menjëherë ka veshur tutat e sportit dhe ka zbritur në fushën e blertë në përgatitjen e skuadrës për ndeshjen pasardhëse. Ecuria e skuadrës deri më tani ka qenë jashtëzakonisht shumë pozitive dhe vazhdon të kryesojë e vetme që prej javës së parë kampionatin e Kategorisë së Parë.

## Në Pallatin e Kulturës Kamëz, koncert i ansambllit “Kaltërsia” me rastin e 7 dhe 8 Marsit

Në Pallatin e Kulturës Kamëz është shfaqur koncerti i ansambllit “Kaltërsia” me rastin e 7 dhe 8 Marsit. Ky koncert është bërë traditë tashmë për ansambllin “Kaltërsia”, i cili në bashkëpunim me stafin e Pallatit të Kulturës Kamëz kanë organizuar herë pas here shfaqje me tematika të ndryshme. Kontributi i vyer për jetën kulturore të qytetit ka vijuar edhe me rastin e ditëve të shënuara të muajit mars, Dita e Mësuesit dhe Dita Ndërkombëtare e Gruas.

Në repertorin e koncertit bënin pjesë numra artistikë të përzgjedhur dhe të realizuar me kujdes e përkushtim nga artistët e vegjël të “Kaltërsisë”, që nga humori, këngët e kënduara nga kori dhe solistët, vallet popullore, kërcimet moderne, pjesët instrumentale etj. Pjesë e rëndësishme e kësaj veprimtarie kulturore ishte edhe ekspozita me punimet në vizatim dhe pikturë të fëmijëve të këtij ansambli.

